



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE

Nr. 27403/1 Prot.

Tiranë, më 05/12 2017

Lënda: Njoftim për miratimin e Udhëzimit “Mbi procedurat e përjashtimit nga TVSH për agrobiznesin në fushën e peshkimit”

**TË GJITHË DEGËVE DOGANORE
TË GJITHA AGJENCIVE DOGANORE
TË GJITHË DREJTORIVE NË DPD**

Bashkëlidhur po ju dërgojmë për njohje dhe zbatim Udhëzimin “Mbi procedurat e përjashtimit nga TVSH për agrobiznesin në fushën e peshkimit”.

Këtë udhëzim, e gjeni të publikuar në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Belinda EKONOMI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE

Nr. 27453 Prot

Tirane, 05/12 / 2017

U D H Ë Z I M

Nr. 11 datë 05/12 2017

**MBI PROCEDURAT E PËRJASHTIMIT NGA TATIMI MBI VLERËN E SHTUAR
PËR AGROBIZNESIN NË FUSHËN E PESHKIMIT**

Në zbatim të shkronjës “b”, pika 38, neni 56, të ligjit nr. 92/2014 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, pikës 3, të nenit 8, të Vendimit nr. 953, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

Mbështetur në ligjin nr. 61/2012 “Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Vendimin nr. 612, datë 5.9.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për dispozitat zbatuese të ligjit “Për akcizat”, të ndryshuar, Vendimit nr. 29, datë 14.1.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave, të sasive, të kushteve dhe kritereve të përjashtimit të anijeve të peshkimit nga taksa e qarkullimit dhe taksa e karbonit”, Udhëzimit nr. 18, datë 15.6.2015, “Për procedurat dhe kriteret e furnizimit të anijeve të peshkimit me karburant (gazoil), me përjashtim nga taksa e qarkullimit, taksa e karbonit dhe akciza”.”,

Bazuar në nenin 737, të Vendimit 651 dt. 10.11.2017 të Këshillit të Ministrave “Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 102/2014, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;

Në mbështetje të pikës 1/b/i të Pjesës VIII/1 të VKM nr. 921, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për personelin e administratës doganore”, i ndryshuar;

Me qëllim zbatimin korrekt nga autoritetet doganore, të procedurave të përjashtimit nga Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSH) të makinerive dhe pajisjeve për peshkim,

U D H Ë Z O J :

I. KUSHTET E PËRGJITHSHME

Kodet tarifore të makinerive dhe pajisjeve për peshkim, për të cilat zbatohet përjashtimi nga TVSH, janë të evidentuara në Aneksin 2, të Vendimit nr. 953, datë 29.12.2014, të Këshillit të

Ministrave, "Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 92/2014, "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

II. PËRFITUES PËRJASHTIMI

Operatorët Ekonomik/Subjektet me aktivitet peshkimi, të pajisur me autorizim "Pritës i regjistruar" nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (DPD);

III. DOKUMENTACIONI

- 1) Një aplikim me shkrim, sipas Aneksit 1, bashkëngjitur, pjesë përbërëse e këtij udhëzimi;
- 2) Kopje të planit të investimit, përfshirë preventivin dhe kohëzgjatjen e investimit;
- 3) Kopje të planit të investimit, përfshirë preventivin, për vitin kur kryhen importet;
- 4) Të dhëna për llojin dhe sasinë e makinerive e të pajisjeve që do të importohen dhe për periudhën e instalimit;
- 5) Kopje të aktit të pronësisë apo të marrjes me qira të ambienteve ku do të bëhet investimi;
- 6) Përshkrimin shtjellues dhe skematik të skemës teknologjike për çdo element të saj;
- 7) Deklaratë e personit të tatueshëm (subjektit), sipas Aneksit 2, bashkëngjitur, pjesë përbërëse e këtij udhëzimi, që makineria apo pajisja, për të cilën kërkohet përjashtimi, nuk është importuar për qëllime shitjeje;
- 8) Kopje e Autorizimit të Pritësit të Miratuar;
- 9) Dokumentacioni i importit: fatura dhe listë ngarkesa;
- 10) Dega Doganore ku depozitohet aplikimi, e plotëson dokumentacionin e mësipërm me kopje të ekstraktit të QKB-së, që duhet të merret nga portali përkatës, ku të jetë specifikuar aktiviteti ekonomik në fushën peshkimit.

IV. PROCEDURA

Përjashtimi miratohet me autorizim të Kryetarit të Degës Doganore. Modeli i autorizimit, është sipas Aneksit 3, bashkëngjitur, pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

Kodi i Procedurës Shtesë, kutia 37.b (DAV): AP0 (dy gërma +1 shifër) - Përjashtim nga TVSH

Autofizimi i përjashtimit nga TVSH^{-ja}, së bashku me Autorizimin e Pritësit të Miratuar dërgohet me email në adresën [s tarifa@dogana.gov.al](mailto:tarifa@dogana.gov.al), për t'u regjistruar në sistemin elektronik.


V. ZBATIMI NË SISTEM

Për çdo procedurë IM4, përjashtohen nga pagesa e TVSH^{-së}, subjektet që janë të regjistruara në sistem (në listën e kompanive me emrin "Peshkimi"), sipas kodeve tarifore të përfshira në listën e kodeve me emrin "Peshkimi".

VI. DISPOZITA TË FUNDIT

Ky udhëzim publikohet në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe hyn në fuqi në datë 05.12.2017.

Belinda IKONÇI
DREJTOR I PËRGJITHSHËM



Drejtuar: Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave
Degës Doganore _____

Lënda: Aplikim për përjashtim nga Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSH) të
makinerive dhe pajisjeve për peshkim

Unë, nënshkruari, me Nr. NUISⁱ:
..... dhe me adresë
.....
kërkoj miratimin për përjashtim nga TVSH, si vijon:

1. Mallrat të cilat kërkohet përjashtim:

Kodi tarifor	Përshkrimi	Sasia

2. Natyra e përdorimit final.....
.....

3. Dokumentet bashkëngjitur:

1.
2.
3.
4.
5.
6.
7.
8.
9.
10.

ADMINISTRATORI

_____, më ____ / ____ / ____

Aneksi 2

DEKLARATË
(Për autoritetin doganor)

DEKLARUESI: (emër, mbiemër, numër ID, vendbanimi)	
STATUSI I DEKLARUESIT: (ortak i vetë, administrator, përfaqësues ligjor ose me prokurë)	
PERSONI JURIDIK: (Emri tregtar dhe Nipt)	
ADRESA : (Selia qendrore dhe vendi i ushtrimit të aktivitetit.)	
VLERA E INVESTIMIT: (vlera e makinerive dhe pajisjeve që importohen, kontrata investimi)	
SASIA E MAKINERIVE QË DO IMPORTOHEN: (preventivi i përgjithshëm dhe pjesor)	
KOHËZGJATJA E INVESTIMIT (sipas planit të investimit)	
PERIUDHA E INSTALIMIT TË MAKINERIVE (preventiv i përgjithshëm dhe pjesor)	
VENDI I INSTALIMIT TË MAKINERIVE (çertifikata pronësie të truallit dhe godinës ose dhe kontrata qiraje me akt noterial)	

Deklaroj se makineritë dhe pajisjet që do të importoj me përjashtim nga pagesa e TVSH – së, nuk janë për qëllim shitjeje.

Emër, Mbiemër (i deklaruesit) _____

Nënshkrimi _____



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
Dega Doganore _____

Nr. _____ Prot

Tiranë, më / / 20

A U T O R I Z I M N R. _____

PËR PËRJASHTIM NGA TATIMI MBI VLERËN E SHTUAR

EMRI I KOMPANISË/SUBJEKTIT
SË AUTORIZUAR:
ADRESA:

NIPT:

AFATI I VLEFSHMËRISË:

KODI SHITESË:

AP0

BAZA LIGJORE E
PËRJASHTIMIT:

Shkronja "b", pika 38, neni 56, e ligjit nr. 92/2014 "Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar; pika 3, e nenit 8, të Vendimit nr. 953, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 92/2014, "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar; Ligji nr. 61/2012 "Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; Vendim nr. 612, datë 5.9.2012, i Këshillit të Ministrave, "Për dispozitat zbatuese të ligjit "Për akcizat", të ndryshuar; Vendim nr. 29, datë 14.1.2015, i Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e procedurave, të sasive, të kushteve dhe kriterëve të përjashtimit të anijeve të peshkimit nga taksa e qarkullimit dhe taksa e karbonit"; Udhëzim nr. 18, datë 15.6.2015, "Për procedurat dhe kriteret e furnizimit të anijeve të peshkimit me karburant (gazoil), me përjashtim nga taksa e qarkullimit, taksa e karbonit dhe akciza".

PËRSHKRIMI I MALLRAVE:

Kodi NK:

DOKUMENTA SHOQËRUESE:

Faturë Nr. datë

VLERË :

SHËNIME:

Konceptoi:

Miratoi:

K R Y E T A R